

K.D.U. 94(496.51-17) "13/14"
272-9(496.51-17) "13/14"

MA. Gjon BERISHA

ASPEKTE TË ORGANIZIMIT KISHTAR NË FAMULLINË E TREPÇËS GJATË SHEKUJVE XIV-XV

Dardania e lashtë, përkatësisht Kosova mesjetare ishte një nga vendet më të njohura xehetarë dhe tregtare të Ballkanit. Gjatë shekujve XIII-XIV u hapën shumë xeherore të pasura, si: Pllana, Bellasica, Bërveniku, Trepça, Novobërda, Janjeva, etj.¹

Në saje të tregtisë dhe xehetarisë dhe disa ngjarjeve tjera me karakter politik e religjioz që u zhvillua në këto vise veçanërisht në fillim të shekullit XIII, na janë të njohura emrat e disa famullive dhe bashkësive katolike të Kosovës, ku në mesin e tyre del edhe famullia mesjetare e Trepçës, emri i së cilës në dokumente mesjetare na del në forma të ndryshme, si: Trepça, Trepçe, Tripçe, Tripza, Trepza etj.²

Lidhur me këto ngjarje dhe të tjera, nga disa dokumente të dalë nga zyrat e Papatit, njihemi edhe me ekzistimin e famullive katolike në Kosovë. Kështu sipas korrespondencës së papës Inoçentit III (1198-1216) nga viti 1204, zihet ngoje ipeshkvi katolik i Prizrenit, e cila në atë kohë ishte një ipeshkvi katolike nën Patrikanën Ortodokse të Tërnovës.³ Gjithsesi deri në shek. XIII ato ishin domen i kishës

1 S. Rizaj. Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII (administrimi, ekonomia, shoqëria dhe lëvizja popullore), Prishtinë 1982, 98-99.

2 K. Jireček. Istorija srba. I. I. (preveo Jovan Radonić) Beograd 1922, 269.; N. Malcolm. Kosova një histori e shkurtër, Prishtinë-Tiranë 2001, 53-55.

3 A. Theiner. Vetera monumenta Slavorum Meridionalium Historiam Illustrantia (Maximam partem nondum edita ex tabulariis Vaticanis), tomus primus, 1198-1549, Romae 1863, XLV, 29.; R. Gruji. Prizrenska eparhija, në: Narodna enciklopedija srpsko-hrvatsko-slovenačka. CXC, III, 1929, 527.

ortodokse të Konstantinopojës që e ushtronte këtu juridiksionin e saj nëpërmjet kryepeshkopatës së Ohrit, “qendrës shpirtërore të perëndimit ballkanik”. Më vonë mbërritja e shtetit serb të Rashës në këta kufij, krijimi i kishës kombëtare serbe (1219) dhe zhvendosja e selisë së saj në Pejë, shënuan tërheqjen e ortodoksisë bizantine dhe forcimin e pozitave të kishës serbe, mbështetur fuqimisht nga dinastia e nemanjidëve.⁴

Megjithatë, ende në gjysmën e parë të shek. XIV besnikët e kishës së Romës dhe ata të kishës së Konstantinopojës ishin të shumtë. Duke pohuar ekzistencën e katolikëve (të cilësuar si “heretikë” e “mosbesimtarë”) dhe të ortodoksëve bizantinofilë (të quajtur ndryshe “gjysmë besimtar”), kodi i Stefan Dushanit zbulon gjithashtu se këto dy besime armike të ortodoksisë serbe, po përjetojnë një ripërtëritje në atë kohë e po bënin proselitë të rinj midis popullsisë vendase. Kjo vlen në radhë të parë për kishën katolike e cila kishte gjetur ndërkohë një mbështetje të fortë në planet e jashtme të fuqive katolike të Evropës me në krye Papatin.

Pikërisht në këtë kohë, Kisha Katolike e Romës, e cila kishte filluar luftën kundër ndikimit të Kishës së Pavarur Ortodokse Serbe, në rrethanat e një rreziku të madh jo vetëm për elementin katolik në territoret arbërore, por edhe për katolikët në Gadishullin Apenin, që vinte nga serbët ortodoksë të bashkuar me perandorët bizantinë, Papati ishte i interesuar të forconte identitetin dhe karakterin lokalo-vendor të Mbretërisë anzuine të Arbërisë, si mbretëri e bazuar në fenë katolike. Ndonëse me një intensitet më të ulët, ku aktivitet i Papatit u shtri edhe në territorin e Kosovës, në veçanti në gjysmën e parë të shekullit XIV.

Lajmet në vazhdim për famullitë dhe për bashkësitë katolike në Kosovë do ti gjejmë në letrën e papës Benediktit XI (1303-1306), shkruar në Lateran, më 18 nëntor 1303, ku përmenden së paku dy famulli katolike në Kosovë: famullia e Trepçës (de Trepzo) dhe Graçanicës (de Grazaniza)⁶. Përmbajtje identike kanë edhe dokumentet

4 M. Šufflay, Die Kirchenzustände im vortürkischen Albanien. Die orthodoxe Durchbruchzone im katholischen Dainme, në: Illyrisch-Albanische Forschungen I, München und Leipzig 1916, 216.; P. Xhufi, Dilemat e Arbërit: studime mbi Shqipërinë e shekujve XI-XVI, Tiranë 2006, 275.

5 Cfr. M. Setton, The Papacy and the Levant (1204-1571), vëll. I, Philadelphia: The American Philosophical Society, 1976, 143-146

6 Cfr. “Benedictus XI papa ad petitionem Marini archiepiscopi Antibarensis eidem...ecclesiis parochialibus ...de Rogosna et de Trepzo...1303. 18 novembris, Laterani”. Acta et diplomata Albania mediae aetatis illustrantia, college Tholloczy, L.- Jiriček, C. –Šufflay, E., vol.I-II,

e papës Klementit VI (1342-1352). përkatësisht dy letrat e shkruar në Avinjon, të dërguara Stefan Dushanit më 6 dhe 7 janar të vitit 1346, ku në mesin e kishave që ishin nën juridiksionin e Ipeshkvisë së Kotorrit, përmenden: Prizreni, Novobërda, Trepça, Janjeva...⁷, në të cilat tani ekzistonte një organizimi kishtar i kishës katolike. Prej këtij viti, Trepça përmendet shpesh nëpër dokumente. Kështu dhjetë vjet më vonë, në dokumentin e Banjskës përmenden qartë edhe sasët si “sasë trepçali”⁸

Në kohën e copëtimit të zotërimeve të Vuk Brankoviqit, megjithatë Trepça mbeti në zotërimin e gruas së tij, zonjës Mara dhe të bijve të saj. Një fare pavarësie Brankoviqet kishin si ndaj turqve po edhe ndaj despotit Stefan. Kështu në vitin 1405 zonja Mara me të bijtë pavarësisht lëshojnë dokument për tregtarët raguzan, sipas së cilave raguzanët morën disa tregje të saj.⁹

Gjate shekullit XV Trepça paraqet një prej tregjeve dhe minierave më të zhvilluara të Kosovës mesjetare, menjëherë pas Novobërdës. Në këtë kohë në Trepçë qëndronin shume “të huaj” e më së shumti raguzan, por kotoras dhe venedikas. Kurse, në mungesë të dokumenteve të kohës, tregtarët vendas shfaqen sporadikisht.¹⁰

Prej familjeve vendase fisnike është e njohur familja Radopi, ngritja e të cilës fillon në vitin 1402 “kur një Rodop” e ndihmoi Gjergj Brankoviqin gjatë ikjes prej burgut të Stambollit, ku e kishte burgosur daja i vet pas Betejës së Ankarasë. Gjoni dhe Stefani “Jouan et Stephan frатели e fioli de Rodop” ikën para në qershor të vitit 1441 në Raguzë. Me ndikim dhe e njohur ishte në Trepçë edhe familja Golemade.¹¹

Sikurse në rastin e famullive tjera katolike në Kosovë edhe për jetën dhe organizimin kishtarë të kësaj famullie, shënime të pasura na sjellin testamentet.

Në testamentin e regjistruar në vitin 1440 të Millat Perkoviqit, dhe që ka të bëjë në tërësi me Prishtinën, përmendet edhe prifti i Trepçës

Vindobonae, 1913-1918, [tribotuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shqipërisë & revista Ekskluzive, Tiranë-Prishtinë 2002.] I, 162, nr.

7 A. Theiner, Monumenta Slavorum I, CCLXXX, 215.; Acta Albanica, II, 4, nr. 20.; I. Božić, O jurisdikciji Kotorske dijeceze u srednjovekovnoj Srbiji, në: Spomenik SAN, CIII, n.s.5, Beograd 1953, 14.

8 K. Jireček, Istorija srba II, (preveo Jovan Radonić), 91, shën. 34.; M. Dinić, Za istoriju rudarstva u srednjovekovnoj Srbiji i Bosni. I deo, Beograd 1955, 5.

9 M. Dinić, Op. cit., II, 402.; J. Drançolli, Op. cit., 141.

10 Ibid, 139-154.

11 Ibid, 141.; M. Jović, Srbija i rimokatolička crkva u srednjem veku, Kruševac 1994, 147.

Marin Veco, të cilit ia le 2 dërhëm, që t'i këndohen mesha në kishën e Shën Katarinës “a dom Marin Vezo in Trepza”.

Petko Radojčkoviç i dhuron kishës në Trepçë “apresso quella ghiesia”, pranë të cilës do të varroset. një libër argjend, kurse priftit që do të angazhohej rreth varrimit të tij i le 6 dërhëm. Me testament nuk e emërton as kishën e as priftin, sikur ndodhë edhe të shumë testamente.

Në testamentin e Radosav Bratuleviçit të hartuar në Koporiq në vitin 1440, përmendën që të dy kishat e Trepçës. Kishës së Shën Mërisë apo Zojës së Bekuar, i le një libër argjend, po ashtu dhe kishës së Shën Pjetrit një libër argjend që janë në Trepçë. Radosavi edhe një libër argjend i le kishës së Shën Mërisë në Prishtinë, “Item lasso a sta Maria in Trepca L uno de argento. Item lasso a sta Maria in Pristina unz 6 de argento”. Posë kishave në testament përmendën edhe emrat e priftërinjve, si: prifti Lazër në Trepçë, prifti Gjergj dhe dominikani Mikeli, të cilëve për mesha ju la “Item lassodom Lazaro, prete de sta Piero ons 6 de argent”, priftit Gjergj “Item lasso a pre Giurag a Beilasiza ons 4 de argento” me vërejtjen “che mi chanta messe”. Kurse, priftit Mikeli “Item lasso a fri Mochaeli a predicatori ducato uno”. Po kështu mbeti kujtimi edhe për priftin në Bellasicë.¹²

Kishën e Shën Pjetrit në Trepçë në testament e përmendë dubrovnikasi Gjon(Ivan) Radohniq, që vdiq në Bellobërdë në vitin 1486. Si pater spiritualis e kishte Jakobin, famullitarin e kishës së Shën Pjetrit në Trepçë “pre Jacouio, pleban ode sancta Pjero de Trepza”. Testamentin e hartoi famullitari Jakob, sipas porosisë së Gjonit prej Bellobërdë dhe para dëshmitarëve.¹³

Testamenti i Juni Ivan(Gjon) Sorkoçeviqit, po ashtu sjell informata për organizimin kishtar në Trepçë. Testamenti ofron shënime të shumta për veprimtarinë, që zhvillonte Juni nëpër famullitë tjera. Sipas testamentit që e cekë M. Diniq, prej një shtëpie që e kishte në Trepçë, “facta cum ligname”. urdhëron që kishës së Shën Mërisë në Trepçë, për çdo vit t'i jepet një libër argjend, dhe prej tyre 12 libra (dërhëm) të ndahen: 3 dërhëm kishës, 3 famullitarit dhe 6 kapelanëve (klerikëve) të tjerë. Gjithashtu Juni urdhëron që nga argjendi edhe prej puseve tjera të punohet këlshejti për kishën e Shën Mërisë në Trepçë, prej dy librave

12 Ibid. 147.

13 B. Hrabak. Dubrovačka naseobina u kopaoničkom rudnik Belom Brdu, Ogledi, Beograd 1953, 64.; G. Gjini. Ipeshkvija Shkup-Prizren nëpër shekuj, Zagreb-Ferizaj 1992, 84, shën.16.

dhe me atë rast të paguhet punimi i tij “calexe uno de l.doe de argento et che se pagi la futura”¹⁴. Është çudi që në këtë testament nuk përmendët fare kisha e Shën Pjetrit. Kjo ka bërë që të disa studiues të shfaqen dyshime në lidhje me ekzistimin dy kishave të veçanta.

Për këto kisha të dhëna të çmueshme na sjellin edhe relacionet e vizitorëve apostolik të papës. Kështu, Imzot Marin Bici, argjipeshkëv i Tivarit në relacionin e tij të vitit 1610, dërguar Selisë së Shenjtë (Vatikanit), ndër të tjera pohon se, gjatë vizitës së tij baritore në famullinë e Trepçës, thotë: “se Trepça asht qytet me 500 zjarre me 40 ose pak gja ma shumë shtëpi latinësh (...) edhe në këtë vend ka sasi të madhe argjendi. Nuk ka kishë në qytet por përjashta (në Stan Tërg Gj. B.)”. Ky është raporti më i vjetër që njohim për këtë kishë. Shënimet e tij janë posaçërisht të rëndësishme, sepse përmbajnë të dhëna mbi vendin se ku ka qenë kisha, mbi materialin nga i cili ka qenë i ndërtuar dhe mbi freskat murale. M. Bici, si duket ka qenë i vetmi që e ka gjetur kishën në gjendje të plotë, meqë udhëpërshkruesit e tjerë të cilët e kanë vizituar, flasin se kjo kishë ka qenë në gërmadhë. Argjipeshkvi Bici në relacionin e tij shkruan: “kjo kishë është shumë e bukur dhe e ndërtuar shumë mirë nga guri i përpunuar i travenitit* (latuar), kurse në brendësi e tërë është e mbuluar me piktura, e pajisun me kelqe, me kryqa t’argjend dhe me veshje të mira”.¹⁵ Në lidhje me këtë problematikë, argjipeshkvi i Tivarit, Bianki (Gjergj Bardhi) me rastin e vizitës në Trepçë gjatë vitit 1642, në një raport të përgatitur për kurinë e Papës, thotë se: “e gjene kishën e vjetër të Shën Pjetrit të lënë pas dore”.¹⁶

Ekzistenca e këtyre kishave katolike vërtetohet edhe vitin 1487, ku prapë dokumentet ekzistimi i posë kishës së Shën Mërisë edhe i kishës së Shën Pjetrit. Me fjale të tjera, më 30 korrik të vitit 1487 Stjepan Ugrinović Zorne është zotuar se do të pikturoj pallën e madhe të altarit për kishën e Shën Pjetrit në Trepçë, me 14 figura njerëzish dhe me peizazhe, ku do të pikturoj skena nga jeta e Shën Nikollës”,¹⁷ me ç’rast e përmend edhe priftin: “Venerabilis domnus de Lapazatis, plebanus ecclesie sancti Patri de Trepza”. Dokumenti përmend edhe priftin të cilit

14 M. Dinić. Trepça u srednjem vijeku. Prilozi za KJIF. knj.XXXIII, sveska 1-2 (1967) 3-10.

15 F. Rački. Izveštaj barskoga nadbiskupa Marina Bizza o svojem putovanju god. 1610, po Arbanaskoj i Staroj Srbiji. në: Starine JAZU. XX. Zagreb 1888. 124.

16 J. Radonić. Rimska kurija i južnoslovenske zemlje od XVI do XVII veka, Beograd 1950, 107-108.; V. Korać. Graditeljska škola Primorja. 39. 42.

17 M. Šuput, Crkva u Starom Trgu, në: Zbornik Filozofskog Fakulteta. XII-1, Beograd 1974, 322.

i dorëzohet palla “per manus presbiteri Tanus de Curianis”. Ekzistimin e dy kishave njëkohësisht e dokumenton edhe M. Diniq duke cituar që Trepça është “koloni katolike në numër dhe që i kishte dy kisha: Shën Mërinë dhe Shën Pjetrin”.¹⁸

Mendohet, se Kisha e Shën Mërisë apo siç quhet ndryshe edhe si Kisha e Zojës së Bekuar në Trepçë, është ndërtuar kah mesi i shekullit XIII me fragmente afreskesh të cilësisë së lartë artistike, që gjendeshin në absidën e godinës.¹⁹ Sipas studiuesit Gj. Mano-Zisi, i cili e kishte vizituara në vitin 1933, kisha ishte e ndërtuar sipas stilit gotik dhe vëren se në kishë gjendeshin dy shtresa të afreskeve, ku ato më të hershmet i takonin shek. XIII kurse ato më të rejt i takojnë shek. XIV. Se kjo kishë është e ndërtuar sipas stilit romaniko-gotik në ndikimin bregdetarë, e cila ishte karakteristike për ndërtimet sakrale katolike në Kosovë dhe pjesën lindore të Adriatikut gjatë shekujve XIII-XIV, këtë e vërteton edhe studiues tjerë, si: A. Deroko²⁰, V. Koraq²¹ etj. Edhe në kohën tonë gjenden gërmadhat e kësaj kishë, e cila ishte restauruar në viti 1967 nga Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës.

18 M. Dinić. Srpsk e zemlje u srednjem veku, Beograd 1978. 405. (cituat nga: M. Jović. Op. cit., 149).

19 M. Folić. M. Lukić. Informativni pregled konzervatorskih radova na spomenicima kulture Kosova od 1962 do 1972 godine, në: Antikitete të Kosovës, VI-VII, Prishtinë 1972-1973, 144.; G. Gjini. Op.cit., 86.

20 A. Deroko. Monumentalna i dekorativna arhitektura u srednjovekovnoj Srbiji. Beograd 1962, 240

21 V. Korać. Graditeljska škola Pomorja. Beograd 1965, 39-42.

MA. Gjon BERISHA

SUMMARY

CHURCH ORGANIZATION IN TREPÇA PARISH BETWEEN THE 14 AND 15 CENTURY

Names of some Parishes and catholic communities in Kosova, such as Medieval Parish of Trepça come to light thanks to the trade and mining activities and other political and religious character events, which took place particularly in the 13th century. Parish of Trepça is first mentioned in 1303, in the letter of Pope Benedict XI (1303-1306), written in Lateran, on November 18, 1303, mentioning at least two catholic parishes in Kosova: Trepça (de Trepzo) and Gračanica (de Grazaniza). This catholic parish continued to get cited in documents of Pope Clement VI (1342-1352), respectively in two of his letters written in Avignon, which he sent to Stefan Dushan on January 6 and 7, 1346. Amongst churches under the Parish of Kotorr, is mentioned Trepça, which had a well-organized church order. From this year on, Trepça is often mentioned on various public character documents.

Similarly to other catholic parishes of Kosova about the organization of the minster life, valuable information is provided by testaments which wealthy people left in possessions to the parish: church of Saint Mary and church of Saint Peter. Accounts of Pope's apostolic visitors, respectively Marin Bici, archbishop of Tivari in 1610 and his successor Gjergj Bardhi (Bianci) in 1642, give a picture of a later situation of the parish and its churches. Both these visitors, depict the church of Saint Mary and church of Saint Peter in Trepça as magnificent churches built in Western architectural Dalmatian style.

